

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rezultatet e PISA 2025, Kumbaro zbulon objektivat: 1 mijë laboratorë inteligjentë dhe kurrikula të reja – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/rezultatet-e-pisa-2025-kumbaro-zbulon-objektivat-1-mije-labora-tore-inteligjente-dhe-kurrikula-te-reja/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	8 shtator 2026, 21:24:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 18:52:50 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dddef8ecde9637f9d964085f5eadf83c7464bf107ccaef10a975a5a3c895704a
TEKSTI	e92c8d0fd1c596bad3331611a74b782d9fde8b4a635e080518ddf7ece04e1838
PAMJA	1e2a82d966eec59824287bd2340fce89b907768ef26c168f93f7490a0a346376

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	db6de033ee3519a1e36acf27a6656374f6b8942097f2a8ee1c2621611fbddc78
E MËPARSHMJA	a75558f850fcbb82e2d38594ebb4632cf91465931132d5e5b522dec4cc398fc
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/db6de033ee3519a1e36acf27a6656374f6b8942097f2a8ee1c2621611fbddc78>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ne testimin PISA 2025, duke i cilesuar ato si nje tregues pozitiv te përmirësimit të sistemit arsimor.

Në një lidhje të drejtpërdrejtë në edicionin qendror të lajmeve në televizionin kombëtar Vizion Plus me moderator Roland Zilin, Kumbaro u ndal te rezultatet në matematikë, shkencë dhe aftësitë digjitale, ndërsa theksoi edhe sfidat që sjell përdorimi i inteligjencës artificiale nga nxënësit.

Ajo bëri të ditur se Ministria e Arsimit ka nisur analizën e rezultateve dhe se objektivat e ardhshëm do të përcaktohen në vijim.

Kumbaro përmendi edhe ndryshimet në kurrikula, investimet në shkolla dhe synimin për krijimin e 1 mijë laboratorëve inteligjentë deri në fund të mandatit.

INTERVISTA E PLOTË:

Çfarë tregojnë më konkretisht këto rezultate të këtij raporti PISA 2025?

Kumbaro: Është shumë interesante të kuptojmë sepse testi i PISA është një test që organizohet nga OECD ku Shqipëria është partnere dhe ku marrin pjesë në këtë testim që bëhet një herë në tre-katër vjet rreth 90 vende. Testi i fundit që ne kemi bërë ka qenë i vitit 2022, ku po të kemi parasysh periudhën mbas tërmetit dhe periudhën pas Covid-it, rezultatet ishin në rënie krahasuar me një periudhë më përpara. Por ana pozitive, edhe kur bie në vlerësim, është sepse të jep instrumente se ku duhet të korrigjohesh, dhe në fakt të gjitha vendet pjesëmarrëse nuk e shohin si një garë mes tyre, por e shikojnë si një mundësi për të përmirësuar aspekte të

5 **Narta "Kaperçen" 230 leke për liter, ekspertët: Gabimi që na bën të kemi...**

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

ndryshme të arsimit. Dhe në fakt kjo ka ndodhur nga viti 2022 deri në vitin 2025 dhe është rezultat i kësaj pune, i rinovimit të kurrikulave, i një programi shumë intensiv të trajnimit të mësuesve, i rishikimit të shumë metodave të punës dhe i investimeve të jashtëzakonshme që janë bërë në arsim, qoftë në infrastrukturë apo në laboratorë që na sollën një rezultat në ngritje shumë të rëndësishëm. Unë mendoj që e krahasojmë njëherë veten me veten tonë me rezultatet e mëparshme, por e krahasojmë edhe me të ngjashmit tanë në rajon. Pa folur këtu që në fakt kishte dhe shumë vende të tjera, qoftë edhe vende të Bashkimit Europian si Greqia, Rumania, Bullgaria që me pikë kishin dalë, kishin pasur rënie dhe kishin rënë edhe më poshtë sesa rezultati që morëm ne.

Lajmi ishte që ne ishim shumë mirë në matematikë dhe në shkencë. Përse në këto dy degë dhe jo në lëndë të tjera?

Kumbaro: Janë tre fusha në të cilat bëhet testim, është matematika, shkenca dhe leximi. Këto janë tre fushat ku zhvillohet testimi. Ka dhe një aftësi tjetër që është aftësia për të përdorur kompjuterin për zgjidhjen e problemeve. Edhe aty Shqipëria, dhe unë në fakt në prononcimin tim në mëngjes nuk e thashë sepse ishte një rezultat që e morëm më vonë, po mund ta ndaj për herë të parë me ju, në këtë aftësi Shqipëria kishte dalë e para në rajon bashkë me Serbinë, ndërkohë që më poshtë ishte Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova, por edhe vende të tjera. Pra këto janë sektorët kryesorë ku bëhet testimi. Ashtu sikurse bëhet dhe një analizë tjetër e shumë qasjeve që kanë nxënësit. Për shembull, unë sot u pyeta në një panel ministrash se si shpjegohet që nga nxënësit e Shqipërisë kishte një perceptim nga organizata që ka një lloj entuziazmi, por një pjesëmarrje në mësim shumë më masive të nxënësve, rezultat që krahasohet gjithashtu edhe me rezultatet e një tjetër testi që bëhet me mësuesit, që quhet testi ose pyetësi i TALIS që u bë vitin e kaluar. Pra është kombinimi i të gjitha këtyre rezultateve që në një farë mënyre secili nga vendet thotë se ku është me parametrat që quhen parametra të një procesi arsimor dinjitoz dhe që i pajis nxënësit me aftësi. Në fund fare qëllimi ky është, a jemi ne në rrugën e duhur për të pajisur nxënësit e shkollave të arsimit parauniversitar me aftësitë e duhura, me instrumentet e duhura, apo a përdorim metodologjinë e duhur apo bëjmë trajnimet e duhura me mësuesit? Dhe tema e madhe e diskutimit sot ishte roli i inteligjencës artificiale si në procesin e të nxënësve, ashtu edhe në procesin e mësimdhënies.

A është teknologjia edhe një sfidë për nxënësit, të cilët ndoshta le të themi e marrin lehtëshëm duke përdorur teknologjinë dhe nuk fokusohen tek studimet

Kumbaro: Është sfida më e madhe me të cilën përballlet sot gjithë planeti. Unë këtu ku jo vetëm unë, por të gjithë kolegët e mi ndanim këtë mendim, duket sikur papritur bota ishte bërë një vend i tërë pa asnjë lloj kufiri, sepse pavarësisht nga madhësia, tradita apo niveli ekonomik i një vendi, ky problem ishte i njëjtë për të gjithë. Pra, le të themi është sfida e kohës dhe gjithë vështirësia, gjithë sfida konsiston në gjetjen e një balance të drejtë midis përdorimit të inteligjencës artificiale për të zhvilluar mendimin kritik dhe mbrojtjen sidomos të brezit më të ri, pra sidomos të arsimit bazë, fëmijët e fillores dhe të nëntëvjeçares nga lehtësia, nga pasiviteti në të cilin mund të biem nëse e keqpërdorim inteligjencën artificiale. Kjo është arsyeja pse ne së fundmi, agjencia jonë për sigurinë e cilësisë në arsimin parauniversitar, sapo ka nxjerrë një udhëzim si një lloj manuali, si një kod etik për mësuesit se si mund të përdoret inteligjenca artificiale në procesin

e mesimanageries. E tregoj kete se pasne qe ka pasur disa keqinterpretime. Nuk ka asnjë vendim për të përdorur ChatGPT-në apo të tjera instrumente të inteligjencës artificiale. Duam apo s'duam ne, nxënësit kanë të gjithë një celular, kanë të gjithë tableta, mësuesit gjithashtu kanë, dhe njerëzit në të përditshmen e tyre, qoftë për arsye pune apo për qëllime të tjera, e përdorin inteligjencën artificiale. Por nëse ne këtë e lëmë pa kontroll dhe nuk vendosim rregullat etike, rregulla të metodologjisë së sa, si dhe me kë duhet ta përdorim, rrezikojmë dhe gabojmë. Pra, nuk është gjë tjetër veçse një udhëzim për mësuesit se si duhet të orientohen në instrumentet që ofron inteligjenca artificiale. Dua të them vetëm një gjë sepse kjo ishte dilema e të gjithë ministrave sot, por edhe e përfaqësuesve të OECD-së. Duket sikur vetëm shkolla duhet t'i bëjë gjërat dhe gjithë problematikat, qoftë problemet sociale, ato kulturore apo ato të inteligjencës artificiale, duket sikur këto mund t'i zgjidhë vetëm shkolla. Në fakt jo, në fakt nuk është kështu. Shkolla bën një pjesë, por shoqëria, shtëpia, familja, ju mediat, shoqëria, rrjetet sociale, familja, nëse të gjithë nuk janë të harmonizuar rreth interesit më të lartë që është interesi i fëmijës, interesi i nxënësit, nuk do të kemi sukses. Në rastin konkret, po flasim për detyrat e shkollës

Kemi tre vite tashmë përpara deri në testin e radhës të Pizës, dhe unë do të doja të dija nëse ju keni vendosur ndonjë objektiv se ku duam të arrijmë?

Kumbaro: Rezultatet u bënë publike sot, ato kërkojnë një refleksim, dhe ndërkohë që ne flasim, ekipi i Ministrisë së Arsimit ka filluar analizën për të gjithë elementët. Ndërkohë që ne flasim, janë përgatitur edhe dy teste të tjera që kanë të bëjnë jo më me 15-vjeçarët, por me 10-vjeçarët, me aftësinë e tyre për lexim dhe aftësinë e tyre në matematikë. Të gjitha këto teste për herë të parë po bëhen online, duke përfshirë edhe PISA që u bë në format dixhital. Pra, të gjitha këto janë momente pune dhe momente refleksimi, dhe sigurisht analiza që ne do bëjmë do të vendosë objektivat e ardhshëm. Por nga ana tjetër, në programin tonë qeverisës ne nuk pritëm rezultatet e Pizës për të thënë se cilat janë objektivat tona. Praktikisht, në të gjithë punën që bëhet, ne kemi filluar rinovimin dhe rishikimin e kurrikulave të reja për arsimin parauniversitar. Në datë 14 fillon viti i ri shkollor dhe për klasën e parë, klasën e gjashtë dhe klasën e 10-të do të futen komplet kurrikulat e reja. Në disa lëndë janë jo vetëm përditësim, por janë krejt të reja dhe me tekste të reja. Kjo do të vazhdojë me klasën e dytë vitin tjetër, klasën e shtatë dhe klasën e 11-të derisa të mbyllet gjithë cikli. Pra ky është një proces shumë i rëndësishëm. Gjithashtu jemi në vazhdim të investimeve shumë të rëndësishme sepse edhe ato janë një pjesë e rëndësishme pse ne arrijmë rezultate të larta. Në këtë vit 2026 mbyllen 40 projekte të reja, shkolla të rindërtuara ose krejt të reja, ndërkohë që ka filluar puna për 40 të tjera. Dhe objektivi tjetër është që deri në fund të mandatit do të kemi 1.000 laboratorë inteligjentë për të pajisur shkollat, si dhe mësuesit e gjimnazeve do të pajisen me rreth 5.500 laptopë. Pra, unë përmenda disa objektiva që ju i gjeni të shkruar edhe në programin e qeverisë të prezantuar shtatorin e kaluar, por e gjitha kjo është punë në proces. Pa folur këtu për projekte të reja, siç mund të jetë liceu francez për të cilin ndoshta do kemi raste të tjera.

/vizionplus.tv

#arsimi

#Kumbaro

#VizionPlus



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh

SOCIALE

Nafta në "flakë",
Brent mbi 108 dollar...

Xhuljana
Zhuleku

39 minuta
më parë

SOCIALE

Rama uron nisjen e
vitit të ri shkollor: Nj...

Xhuljana
Zhuleku

3 orë më
parë

SOCIALE

Gjykata e Vlorës i jep
fund bojkotit: Nga e...

Taulant Halili · 12 Sht



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë

Bota

Vendi

Kronikë

Lifestyle

Programe

Programe

Seriale

Guida TV

Video

Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh

Karriera

Kontakt

Reklamo me ne

Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit

Privatësia

Cookies

Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.